



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3696/b Prot.

Shkodër, më 01.11.2018

Lenda: Dergohet projekt-vendim dhe relacion

Drejtuar: Keshillit Bashkiak

Te nderuar keshilltare!

Bashkelidhur ju dergojme per shqyrtim projekt – vendimin dhe realcionin:

Për ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51 datë 14.04.2009 “Miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr.421 datë 2.6.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, sipas lidhjes 1, me numër rendor 17-18-19-22-23, sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore bashkëlidhur.

Duke ju uruar pune te mbare.

Me respekt,

KRYETAR

Voltana Ademi
Voltana Ademi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më _____.____.2018

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2018

Për ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51 datë 14.04.2009 për “Miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr.421 datë 2.6.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, sipas lidhjes 1, me numër rendor 17,18, 19, 22, 23, sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore bashkëlidhur.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____.____.2018, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 9, pika 1.2 germa a dhe c; neni 54 pika e, ligjit Nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të ligjit Nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, VKM Nr. 421, datë 2.6.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, Raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 491/15 date 30.11.2017, urdhërit nr.982 date 12.12.2017 “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-se”, relacionit të kryetarit të Bashkisë Shkodër .

VENDOSI :

Miratimin për ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51 datë 14.04.2009 për “Miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në

pronësi të Bashkisë Shkodër”, për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr.421 datë 2.6.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë shkodër, të qarkut të shkodrës”, të ndryshuar, sipas lidhjes 1,

me numer rendor 17 : ish zyrat te sektorit te I-re te Nd/jes Komunale Banesa

me numer rendor 18 : zyre e magazine te sektorit te I-re te Nd/jes Komunale Banesa

me numer rendor 19 : ish dekori

me numer rendor 22 : ish zyrat e rajonit te ndermarrjes artistike

me numer rendor 23 : : ish zyrat e rajonit te ndermarrjes artistike

sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shteterore, bashkëlidhur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

ZV/Kryetar

Drejtorja Juridike

Drejtorja e Financës





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2018

RELACION

Për ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51 datë 14.04.2009 për “Miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr.421 datë 2.6.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, sipas lidhjes 1, me numër rendor 17- 18- 19- 22 - 23, sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore bashkëlidhur.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Referuar raportit përfundimtar të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.491/15, datë 30.11.2017, përkatësisht rekomandimeve nr.28, nr. 29, dhe urdherit nr.982 date 12.12.2017 të kryetares së Bashkisë, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së”, për heqjen nga lista e pronave, të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, me VKM-në Nr. 421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme), të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, sipas lidhjes 1 :

me numer rendor 17 : ish zyrat te sektorit te I-re te Nd/jes Komunale Banesa

me numer rendor 18 : zyre e magazine te sektorit te I-re te Nd/jes Komunale Banesa

me numer rendor 19 : ish dekori

me numer rendor 22 : ish zyrat e rajonit te ndermarrjes artistike

me numer rendor 23 : : ish zyrat e rajonit te ndermarrjes artistike

Sa me siper ju informojme ;

Me VKM nr. 421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë shkodër, të qarkut të shkodrës”, Bashkisë Shkodër i janë transferuar sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet Vendimit, pronat e sipercituara me numer rendor 17- 18- 19- 22- 23, si prona që përdoren në fushen administrative, me të dhëna si më poshtë :

r. nd.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale Prones (m2)	Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
7	8594 N-7	2/51, 2/52, 2/53	Nd.Truall	Ish zyra te sektorit I-re te Nd/jes Kom Banesa	168	110	Ish zyre	Bashkia	Bashkia Nd Komunale	E zene
3	8594 N-7	2/54	Nd.Truall	Zyre e mag sekt I-re Nd KomBanesa	20	20	Ish zyre	Bashkia	Bashkia Nd Komunale	E zene
9	8594 N-7	2/61	Nd.Truall	Ish Dekori	530	530	Repart pune	Bashkia	Bashkia Nd Komunale	E zene
2	8594 O-9	10/8	Nd.Truall	Ish zyrat e rajonit tek Artistikja	20	20	Zyre	Bashkia	Bashkia Nd Komunale	E zene
3	8594 O-9	10/9	Nd.Truall	Ish zyrat e rajonit tek Artistikja	1081	242	Zyra	Bashkia	Bashkia Nd Komunale	E zene

Nga Bashkia Shkoder eshte bere identifikimi i origjines se pasurive te rregjistruara dhe konfirmuara nga ZVRPPShkoder, duke zoteruar dokumentacionin perkates , te pasurive qe perfshihen ne listat e VKM 421 date 2.06.2010, kaluar ne pronesi te Bashkise Shkoder, konkretisht; me shkresën nr.2962 dt.06.09.2010 eshte drejtuar ZVRPP Shkodër, për të bërë identifikimin e plotë të origjinës për pronat me numer rendor nr.17, nr.18, nr.19 , nr.22 dhe nr.23 sipas lidhjes 1, në listen e inventarit te pronave të regjistruara në ZVRPP ne emer te Bashkise Shkodër .

I-Për pronat me numer rendor nr.17 , nr:19 sipas lidhjes 1, në listen e inventarit te pronave;

Prona nr.17, me nr. pasurie 2/51,2/52,2/53 dhe prona nr.19,me nr pasurie 2/743 në Z.K. 8594 në Vol.24, fq. 115 rezulton e transkriptuar në radhorin e pronësisë me nr. 2210, datë 26.12.1995, në favor të familjes Djepaxhija, prona te fituara me kontratë shitje realizuar nga Dega e Agjencisë së Privatizimit Shkodër me datë 6.12.1995 , me të drejten e parablerjes në bazë të vendimit KKP nr.114, datë 26.08.1994.

Pasuria me nr. 2/61, Zona kadastrale 8594 ,është ndarë në pasurinë me nr.2/766 e regjistruar në Vol 27, fq.81 dhe pasurinë me nr.2/801 e regjistruar në Vol 28, fq.6 e regjistruar në favor të Familjes Djepaxhija

II Për pronen me numer rendor nr.18, sipas lidhjes 1, në listen e inventarit te pronave, rezulton si me poshte;

Prona nr.18 me nr.pasurie 2/54 , me sipërfaqe 20 m² transferuar ne pronësi të Bashkisë Shkoder, rezulton e regjistruar ne ZVRPP Shkoder sipas Çertifikates per vertetim pronesie , nr. 735988 , data e lëshimit të Çertifikatës 15.11.2013 në pronësi të Ermir Qamil Akshija, ne vol 6, faqe 73.

III- Për pronat me numer rendor nr.22, nr.23 sipas lidhjes 1, në listen e inventarit te pronave, rezulton si me poshte;


Prona me nr.22 dhe prona nr 23 me nr. pasurie 10/9, ZK 8594, Indeksi SH-O-9,Vol 31, Fq 11, rezultojne me pronar Albina Gjonej, Agetina Gjonej, Andi Gjonej, Eftali Gjonej, Silvana Gjonej, Anila Gjonej.

Referuar sa më sipër i drejtohem i keshillit Bashkiak për të bërë miratimin e ndryshimit të pjeshëm të VKB nr.51 datë 14.04.2009 "Miratimin e listës së pjeshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër", për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr.421 datë 2.6.2010, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjeshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, sipas lidhjes 1, me numër rendor 17 me emertim prone (ish zyra te sektorit I-re te Nd/jes komunale banesa) ,nr.18 me emertim prone (zyre e magazines, sektorit I-re te Nd/jes komunale banesa), nr.19 me emertim prone (ish dekori), sipas lidhjes 1, në listen e inventarit te pronave,nr.22 me emertim prone (ish zyrat e rajonit tek artistikja), nr.23 me emertim prone (ish zyrat e rajonit tek artistikja), sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar!



ZV/Kryetar



Drejtoria Juridike

Drejtoria e Financës

1. FORMULAR PER HEQJE NGA INVENTARI I PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

Identifikoi: Adnan Bushati Specialist sektori I asetëve

Bashkia SHKODER

Supervizoi: Manjola Lesha Pergjegjese sektori I asetëve

Fusha e perdorimit te Prones: Administrative

Aprovoi: Voltana Ademi Kryetar Bashkie

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)



Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjese administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
17	8594 N-7	2/51 2/52 2/53	Nd. Truall	Ish zyrate sektorit I-re te Nd/jes Kom Banesa	168	110	Ish zyre	Bashkia	Bashkia	
18	8594 N-7	2/54	Nd. Truall	Zyre e mag sekt I-re Nd KomBanesa	20	20	Ish zyre	Bashkia	Bashkia	
19	8594 N-7	2/61	Nd. Truall	Ish Dekon	530	530	Repart pune	Bashkia	Bashkia	
22	8594 O-9	10/8	Nd. Truall	Ish zyrat e rajonit tek Artistikja	20	20	Zyre	Bashkia	Bashkia	
23	8594 O-9	10/9	Nd. Truall	Ish zyrat e rajonit tek Artistikja	1081	242	Zyra	Bashkia	Bashkia	

PLAN RILEVIM

FAMILJA DJEPAXHIA

PERGATITI

DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI ASETERVE

Specialist Adnan Bushati



IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8594
NR.PASURISE- 51, 52, 53
INDEKSI I HARTES J-8
SHKALLA 1:500
ADRESA PASURISE RRETHI SHKODRES
QYTETI SHKODER

MIRATOHET
KRYETAR I BASHKISE
VOLTANA ADEMI

PRONARI
FAMILJA DJEPAXHIA



PERGATITI

DREJTORIA JURIDIK

SEKTORI ASETEVE

Specialist Adnan Bushati

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8594

NR.PASURISE- 61

INDEKSI I HARTES J-8

SHKALLA 1:500

ADRESA PASURISE RRETHI SHKODRES

QYTETI SHKODER

MIRATOHET

KRYETAR I BASHKISE

VOLTAHA ADEMI

PRONARI

FAMILJA DJEPAXHIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tel +355 224 7273 keshilli.bashkiak@yahoo.it

V E N D I M

Nr. 51, datë 14.04.2009

“ Miratim i listës së pjesshme të pronave të paluajtshme Shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër (lista e transferimit) ”


Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të datës 14.04.2009, me propozim të Kryetarit të Bashkisë , dhe në mbështetje të ligjit Nr.8652 datë 31.07.2000 “ Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 3, ligjit nr. 8744, dt. 22.02.2001 “Për transferimit e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të VKM nr. 500, dt. 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 15, dt. 30.06.2003, VKM. Nr. 366, dt. 27.03.2008 “Për miratimin e listës paraprake të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër”, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I

1. Të miratojë listën e pjesshme të pronave të paluajtshme Shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër.
2. Paraqitjen e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Aseteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.

Lista përfundimtare e pronave kërkohen për transferim në pronësi

I	7, 13÷23	Prona që përdoren në fushën administrative
II	32÷73;851;852;853	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e arsimit
III	78÷86;90÷95;854	Prona që përdoren në fushën e shëndetsisë (shërbim parësor
IV	216;218÷225(pjesa e paprivatizuar 225);228÷234;	Prona që përdoren për realizimin e programeve në sportive dhe kulturore



V	235;241÷248	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social
VI	107÷109;121÷135;173÷205;840-845	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik
VII	283÷329	Prona që përdoren në fushën e strehimit, apartamenteve të privatizuara
VIII	330÷403	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes
IX	621÷631	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik
X	562-571; 619-620	Infrastrukturë vendore
XI	578;579,855	Shërbim funeral

KRYETARI
Bardhyl LOHJA

